



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Froni 1" Sh.P.K. të datës 05.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit te kurrizit Dardani" me nr. të prokurimit 616-23-13568-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Froni 1" Sh.P.K. të datës 05.08.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit te kurrizit Dardani" me nr. të prokurimit 616-23-13568-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Froni 1" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 05.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 02.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit te kurrizit Dardani" me nr. të prokurimit 616-23-13568-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: “Për në OE Ofertues është kërkesë tejet e çuditshme dhe absurde – sidomos kur marrim parasysh dispozitat ligjore të cilat rregullojnë qarkullimin e mjeteve në Republikën e Kosovës – sidomos makinerive për të cilat janë kërkuar sqarimet shtesë. Kompania e perzgjedhur, ka mungesa ne dosjen e tenderit, si p.sh. 1. Mungon Plani Dinamik 2. Vleresimi I rrishtut është I jashtafatshem, pasiqe sipas Ligjit 04 L-161 per siguri dhe shendet ne pune, vleresimi ka vlefshmeri vetem 24 muaj (2 vite), ndersa, OE ka prezantuar vleresimin e rrishtut te bere me 18.10.2021 dhe ka skaduar me date 17.10.2023, ndersa ofertimi është bere me 16.02.2024, pra, 4 muaj pasi ka skaduar vleresimi I rrishtut sipas ligjit te kerkuar ne dosjen e tenderit. Certifikatat e ISO, te prezantuara, nuk jane te leshuara nga kompani te akredituara ne IAF (International Accreditation Forum) ose IAF Certification Validation - IAF CertSearch e cila është faqja kompetente per akreditimin e te gjitha drejtorive akredituese ne Ministrite perkatese dhe WQR qe ka leshuar certifikatat nuk është e akredituar ne drejtorine pergjegjese akredituese nga vendi qe vjen dhe as ne IAF ose IAS, me ç’rast, nese kerkohet kompania EING COM SHPK ne IAF, gjendet vetem certifikata ISO 39001 e cila nuk është kerkuar ne kete dosje te tenderit, pra kompania EING COM SHPK, ne forumin nderkombetar te verifikimit te ISO standardeve ka te regjistruar vetem ISO 39001. Se paku, autoriteti kontraktues, është dashur te kerkoje verifikimin e trupes qe ka leshuar certifikatat 9001-2015, 14001-2015 si dhe 45001-2018, te cilat mund te leshohen nga kushdo duke krijuar nje faqe ne internet, mirepo nuk jane te verifikuara as ne drejtorine e akreditimeve te Republikes se Turqise. (TURKISH ACCREDITATION AGENCY). Dhe AK, nuk është interesuar fare nese kjo kompani e leshimit te ketyre certifikatave. Sic duket, vetem Vedat Poterqoi mund ti kaloje keto certifikata te paverifikuara dhe te dyshimta per falsifikim. Theksojme, kompania qe ka leshuar keto certifikata nuk është e akredituar dhe nuk gjendet ne listen e kompanive te akredituara nga Turkish Accreditation Agency”.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Lidhur me Operatorit Ekonomik, Grup i Operatorëve Ekonomik FRONI 1 SH.P.K.; ILEAA – GR SH.P.K., komisioni pas shqyrtimit të vendimit të OSHP duke vepruar bazuar në të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna, nga pretendimet ankimore të paraqitura prej Operatorëve Ekonomik, me datën 12.07.2024 i ka dërguar kërkesë për sqarime Operatorit Ekonomik GOE Froni 1 Sh.P.K. IleaA-Gr Sh.P.K.

Me datën 13.07.2027 kemi pranuar sqarimet nga GOE Froni 1 Sh.P.K. IleaA-Gr Sh.P.K për paisjet 1. Eskavator mobil-Skip, 2. Lugë ngarkuese deri në 3t, 3 Autofshesë speciale deri në 3t dhe 4. Mjet vetëshkarkues (damper) 2-3 m3.

Komisioni pas shqyrtimit të sqarimeve dhe vendimit nga OSHP: 2024/0253 dhe specifikacionit në dosjen e tenderit të datës 02.02.2024, konstaton se sqarimet e dërguara janë të mangta, të pa dëshmuara me kërkesën për sqarime, bazuar në dosjen e tenderit dhe vendimin e OSHP: 2024/0253.

Pas shqyrtimit të sqarimeve të dërguara më datë 13.07.2024, nga Operatori Ekonomik GOE Froni 1 Sh.P.K, lidhur me aneksin 7 të dosjes së tenderit e cila përcakton qartazi specifikat e pajisjeve të kërkuara sipas procedurës tenderuese. Komisioni për rivlerësim të procedurës “ Renovimi artistik dhe infrastrukturor i tunelit të kurrizit – Dardani”, konstaton se i njeti Operator Ekonomik në përgjigjet e ofruara nuk ka dëshmuar se i përmbushë kërkesat e Autoritetit Kontraktues sipas dosjes dhe aneksit 7 për kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika e pestë e kërkesës 5.Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit ; Aneksin 7 të DT.

Në po të njëjtën pikë dëshmitë e kërkuara nga AK kanë qenë të specifikuara qartazi ashtu si: OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e paisjeve duke plotësuar Aneksin 7 duke i bashkangjitur libreza

valide. Në rast të marrjes me qira duhet të dëshmohet me marrëveshje të noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Operatori Ekonomik GOE Froni 1 Sh.P.K, në listën e pajisjeve profesionale në ofertën e dorëzuar nuk ka bashkangjitur librezat e pajisjeve ashtu siç kërkohen, dhe poashtu sipas sqarimeve nuk ka dokumentuar sipas kërkesës dhe dosjes, andaj i njëjti konsiderohet i papërgjegjshëm sepse nuk i përmbush kushtet dhe kriteret sipas dosjes së tenderit.

Në përputhje me vendimin e OSHP:2024/0253, komisioni vlerësues ka kërkuar sqarime shtesë nga parashtruesi me qëllim të konfirmimit nëse janë plotësuar kërkesat sipas aneksit 7 të dosjes së tenderit. Parashtruesi ka kthyer sqarimet mirëpo komisioni vlerësues ka gjetur se parashtruesi edhe përmes këtyre sqarimeve nuk ka arritur që të dërgoj dëshmitë e kërkuara dokumentare për kërkesat sipas aneksit 7 të DT. Pas analizimit me kujdes të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se të gjitha arsyet e komisionit vlerësues sipas letrës standarde për parashtruesin si tenderues të eliminuar janë arsye të bazuara dhe të sakta në tërësi, sikurse janë cituar edhe më sipër në këtë vendim dhe pa pasur nevojë që të përsëriten sërish. Prandaj pretendimet ankimore të parashtruesi përmes të cilave janë kundërshtuar arsyet për eliminimin e tij janë pretendime ankimore të pabazuara.

Sa i përket pretendimeve të tjera ankimore të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar në këtë aktivitet të prokurimit, duhet sqaruar se parashtruesi përderisa vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të dëshmojë asnjë interes të vetëm material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë. Përmes nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP përcaktohet se *“Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, përderisa parashtruesi për vete ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, dhe nuk ka arritur që të dëshmojë të kundërtën as me këtë kërkesë për rishqyrtim, atëherë i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë. Megjithatë duhet cekur se tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë tërësisht të përgjegjshme. Me qëllim që të konfirmohet ky fakt, AK ka verifikuar vlefshmërinë e certifikatave ISO të dorëzuara nga tenderuesi i rekomanduar dhe ka gjetur se të gjitha këto certifikata janë të rregullta dhe janë me validitet. Linku në të cilën mund të verifikohen nga kushdo këto certifikata është si në vijim: <https://wqrcert.com/sorgulama.php>. Kësisoj është gjetur se oferta e tenderuesit të rekomanduar është e vetmja ofertë e përgjegjshme me çmimin më të lirë. Prandaj rekomandimi për dhënie të kontratës nga komisioni vlerësues është në përputhje të plotë me kriteret e dhënies së kontratës sipas dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera, edhe po të ishte palë e interesuar parashtruesi në raport me këto pretendime, sërish pretendimet e tij janë në tërësi të pabazuara. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të parashtruesit kundër tenderuesit të rekomanduar për kontratë janë të pabazuara.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 12.08.2024

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.